VENDIM
Nr. 249, datë 24.4.2019

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MALËSI E MADHE, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KOPLIK, TË PASURIVE NR. 161 DHE 161/1, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 2220, PËR NDËRTIMIN OBJEKTEVE "STADIUM" DHE "QENDËR SHUMËSPORTËSHE" DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 296, DATË 12.3.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË BASHKINË KOPLIK, TË QARKUT TË SHKODRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "d", 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe, për njësinë administrative Koplik, të pasurive nr. 161 dhe 161/1, zona kadastrale 2220, sipas planimetrisë dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e objekteve "Stadium" dhe "Qendër Shumësportëshe" në njësinë administrative Koplik.
2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 296, datë 12.3.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Koplik, të Qarkut të Shkodrës", të shtohen pronat e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Bashkisë Malësi e Madhe i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t'i tjetërsojë ato ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Malësi e Madhe dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te paluajtshme)

Identifikoi: _____
(emer, mbiemer, pozicion zyrtar)

Njesia Administrative: Koplik, Bashkia Malesi e Madhe

Supervizoi : _____
(emer, mbiemer, pozicion zyrtar)

Fusha e perdorimit te prones: **Bujqesia dhe Ushqimi**

Aprovoi: **Tonin Marinaj**
(emer, mbiemer, pozicion zyrtar)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastrale	Nr.Pasurise	Lloji I Prones	Emeri I Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/ Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2220 K-34-63-(94-B)	161	Are	Are Njesia Administrative Koplik	34,407		Are	MBZHR	D.B.U. Shkoder	
2	2220 K-34-63-(94-B)	161/1	Livadh	Livadh Njesia Administrative Koplik	50,000		Livadh	MBZHR	D.B.U. Shkoder	


PLAN RILEVIMI
(fragment)
PERGATITI:
Emri: Ing.ERJETA RAMAJ(ZEKA)
Licenca:T.0236/1 date. 03.06.2013
Data e pergatitjes 10.09.2018
(Vula)
A.IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE :2220
Nr.PASURISE : 161+161/1
INDEKSI I HARTES K-34-63- (94-B)
SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE Rrethi M.MADHE
Q/F_kopilik
PRONARI :
Sip. 81528m2
94-B)
161/1
160
162
164
165
166/1
154
74
78
79
80
71/1
77/1
83/1
83/2
82
106
107
114
115
116
118/1
133/1
108
KO